



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. <u>01-858/14</u>
Dep. <u>03</u>	Br. Prot. <u>01-858/14</u>
Nr. I faq.	Data
Broi stranica	Datum
Nr. pages	Date <u>13-03-2014</u>
PRISHTINE	

DATE/A:	12/03/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Adem DURIQI Drejtor i Prokurimit - Komuna e Lipjanit
CC:	z. Imri AHMETI Kryetar – Komuna e Lipjanit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Tërheqja e automjeteve sipas porosisë (shërbime të Merimangës)”



I nderuar z. DURIQI,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: “Tërheqja e automjeteve sipas porosisë (shërbime të Merimangës)” me nr. të prokurimit:18163-014-008-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Tërheqja e automjeteve sipas porosisë (shërbime të Merimangës)” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Lipjanit ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull: “Tërheqja e automjeteve sipas porosisë (shërbime të Merimangës)” me nr. të prokurimit: 18163-014-008-221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë: 26/02/2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e Prokurimit Publik në Kosovë.

Në Njoftim për Kontratë, tek pika II.1.5) Përshkrimi i shkurtër i lëndës së kontratës, është kërkuar: Tërheqja dhe bartja e të gjitha llojeve automjeteve sipas porosisë (shërbime të Merimangës) dhe deponimi i tyre në parking (pllac) i cili është vend parking sigurt për këtë shërbim dhe i cili duhet të jetë jo më larg se **5 km** nga qyteti i Lipjanit. Po ashtu në pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, pika 4 kërkohet: Oborri (vendi) për parkimin, ruajtjen e automjeteve që tërhiqen në bazë të urdhëresës së policisë apo inspektorëve, largësia maksimale nga qendra e qytetit të Lipjanit 5km. Kërkesat e cekura janë pothuajse të ngjashme, por në Dosja e Tenderit, Pjesa II. Fleta e të dhënave të tenderit (FDT), tek pika 9.1 Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, kërkohet: Oborri (vendi) për parkimin, ruajtjen e automjeteve që tërhiqen në bazë të urdhëresës së policisë apo inspektorëve, largësia maksimale nga qendra e qytetit të Lipjanit **7km**. Vendosja e kilometrave është kriter diskriminues dhe në të njëjtën kohë favorizon operator të caktuar ekonomik. Përpos kësaj, mospërputhja në mes kriterit në Njoftim për Kontratë dhe në Dosja e Tenderit është shkelje e legjislacionit të prokurimit. Operatorët Ekonomik në parim njoftohen përmes Njoftimit për Kontratë, dhe nëse iu kishin referuar kriterit **5 km** nga qendra e Lipjanit, e janë më larg se **5km**, nuk kishin shfaq interesim për tërheqjen e Dosjes së Tenderit duke humbur mundësinë e aplikimit në këtë aktivitet prokurimi.

Në Njoftim për Kontratë në pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, Autoriteti ka kërkuar: “2.Posedimi i mjeteve me mekanizëm që e bëjnë të mundur ngarkimin e automjetit pa lëvizje” Në këtë rast, Autoriteti ka paraqitur një kërkesë për të cilën nuk ka kërkuar dëshmi dokumentare. Operatori Ekonomik duhet ta posedoj mekanizmin, por nuk i është kërkuar ta dëshmoj. Me këtë rast, Autoriteti Kontraktues nuk ka se si të vlerësoj ofertën e Operatorit në mënyrë objektive.

Komuna e Lipjanit, si Autoriteti Kontraktues këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka paraparë në Planifikimin e Prokurimit të vitit 2014, e as nuk iu është ofruar Agjencisë ndonjë dëshmi nga Autoriteti Kontraktues se është njoftuar Agjencia Qendrore e Prokurimit. Ligjit i Prokurimit mundëson që Autoritetet Kontraktuese mund të zhvillojnë një aktivitet të pa planifikuar, por paraprakisht Autoriteti Kontraktues duhet që së paku pesë ditë para fillimit të aktivitetit ta njoftoj Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; Nenin 8 Planifikimi i Prokurimit; si dhe Nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë aktivitetit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për operatorët shërbyes ose shërbyesit potencial. Pra, të shmanget çdo praktikë që krijon konfuzion tek një shërbyes i caktuar ose shërbyes potencial.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !